



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.18.dt.03.03.2000

MBI

**CELJEN E FONDEVE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË PËR
PERBALLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE PËR VITIN 2000**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës në mbledhjen e tij të dt.03.03.2000 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Sporteve dhe Drejtoria e Financës “Për çeljen e fondeve nga të ardhurat e Bashkisë për përballimin e aktiviteteve sportive për vitin 2000 në mbështetje të ligjit Nr.8114 dt.28.03.1996 “Për Sportin” neni 19 “Klubet dhe Shoqatat Sportive” paragrafi 2, si dhe në mbështetje të Ligjit nr.7572 dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Kreu 2, neni 14 “Për kompetencat e këshillave e komunave të Bashkive”, në mbështetje dhe të VKM nr.441 dt.15.08.1994 “Rregullore për kompetencat dhe detyrat e administratës të Bashkisë e Komunës”, pika 10 “Detyrat e seksionit ose zyrës së Kulturës e Rinisë, Sporteve e Shoqatave” paragrafi 10.5 dhe 10.6

V E N D O S I

1. Të akordojë fondin prej 4.500.000 lekë (mijë/lekë) për Klubin shumë sportesh “Tirana”
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sportit dhe Drejtoria e Financës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
ORHAN SAKIQI

